



100 Vjet Pavarësi

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE
-Këshilli Drejtues-

V E N D I M

Nr.1977, datë 14.06.2012

Per

“Miratimin e dokumentit “ Rregullore per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit te tyre”” dhe publikimin e qendrimit te AKEP mbi komentet e paleve te interesuara.

Këshilli Drejtues (*KD*) i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (*AKEP*), i përbërë nga:

- | | | |
|----------------|------------|---------|
| 1. Z. Piro | Xhixho | Kryetar |
| 2. Z. Alban | Karapici | Anëtar |
| 3. Znj. Alketa | Mukavelati | Anëtar |
| 4. Z. Benon | Paloka | Anëtar |
| 5. Znj. Zamira | Nurçe | Anëtar |

dhe sekretare Znj. Marsida Drushku, në mbledhjen e datës2012, sipas procedurës së përcaktuar në Ligjin Nr. 9918 datë 19.05.2008 “Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr. 8480, datë 27.05.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike” dhe në Rregulloren e Brendshme të AKEP-it, mori në shqyrtim, çështjen me objekt:

Miratimin e Rregullores “Per pajisjet radio dhe fundore te telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit te tyre” dhe publikimin e qendrimit te AKEP mbi komentet e paleve te interesuara.

BAZA LIGJORE:

1. Kodi i Procedurës Administrative (*KprA*);
2. Shkronja p) e Nenit 8, nenet 79 dhe 110 të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “ Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë” (*Ligji Nr. 9918*);
3. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 14.04.2011 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”” (*Vendim i Këshillit të Ministrave*);
4. Pika 17 e Nenit 21 të “Rregullores së Brendëshme të AKEP (ish ERT)” (*Rregullorja e Brendshme*), miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues (*VKD*) të ERT-së, Nr. 170, datë 24. 04. 2004, e ndryshuar dhe në fuqi sipas Pikës 3 të Nenit 138 të Ligjit Nr. 9918;

K Ë SHILLI D R E J T U E S:

Nga shqyrtimi i materialit shkresor si më poshtë:

1. Relacioni shpjegues mbi perfundimin e keshillimit publik të dokumentit të Rregullores “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre”;
2. Dokumenti “Rregullore për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre”;
3. Projektvendimi përkatës; si dhe,
4. Diskutimet në mbledhje mbi çështjen;

Duke iu referuar bazës ligjore të sipërcituar,

V Ë R E N se :

1. Dokumenti “Rregullore për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre” është përgatitur në përputhje me kuadrin ligjor dhe nënligjor përkatës.
Hartimi i Rregullores është kryer në mbështetje të Direktivës 1999/5/EC (Mbi pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen reciproke të konformitetit të tyre) dhe bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 14.04.2011 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve””.

Ky dokument përcakton kërkesat thelbësore që duhet të plotësojnë pajisjet radio e pajisjet fundore të telekomunikacioneve, të cilat futen në treg dhe vendosen në shërbim në Republikën e Shqipërisë. Ky dokument është parashikuar të zbatohet për

pajisjet radio e pajisjet fundore të telekomunikacioneve të importuara, si dhe për ato pajisje që mund të prodhohen në Shqipëri në të ardhmen.

Ne kete Rregullore trajtohet procedura e njohjes se konformitetit per pajisjet radio qe punojne ne breza frekuence te paharmonizuara.

Gjatë hartimit të Rregullores janë parashikuar gjithashtu procedurat e vlerësimit të konformitetit, shënimi i pajisjeve R&TT me shenjat përkatëse të konformitetit dhe roli që duhet të luajë AKEP në mbikqyrjen e tregut të pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve në vendin tonë.

P Ë R K Ë T O A R S Y E:

Bazuar në Kodin e Procedurave Administrative, Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008 dhe VKM Nr. 331, datë 14.04.2011 ,

V E N D O S:

1. Miratimin e dokumentit “Rregullore për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre” dhe publikimin e qendrimit te AKEP mbi komentet e paleve te interesuara, sipas lidhjes bashkengjitur.
2. Ky vendim të publikohet në faqen e internetit www.akep.al

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R I

Piro XHIXHO

ANËTARËT E KËSHILLIT DREJTUES:

1. **Alban KARAPICI** _____
2. **Alketa MUKAVELATI** _____
3. **Benon PALOKA** _____
4. **Zamira NURÇE** _____



REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

RREGULLORE

Nr.25, datë 14.06.2012

**Per Pajisjet Radio dhe Fundore
te Telekomunikacioneve dhe
Njohjen e Konformitetit te tyre**

Miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues të AKEP Nr. 1977 date 14.06.2012

Në mbështetje të Ligjit Nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 14.04.2011 “Per miratimin e Rregullit Teknik “Per kerkesat thelbësore dhe vleresimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve””.

KËSHILLI DREJTUES I AKEP

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi i rregullores

Kjo Rregullore ka për qëllim të përcaktojë rregullat që duhen ndjekur për importimin, vendosjen në treg, lëvizjen e lirë dhe venien në shërbim të pajisjeve radio e të pajisjeve fundore të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë.

Rregullorja është hartuar duke u mbështetur në Direktivën 1999/5/EC “Mbi pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve si dhe njohja reciproke e konformitetit të tyre”.

Neni 2

Fusha e zbatimit

1. Kjo Rregullore zbatohet nga fabrikuesit, përfaqësuesit e autorizuar të fabrikuesve, subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në tregun shqiptar (importuesit dhe/ose tregtuesit) dhe nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike (kur blerja bëhet prej tyre jashtë tregut Shqiptar).
2. Kjo Rregullore zbatohet për pajisjet e radiokomunikimit dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve.
3. Kjo Rregullore zbatohet gjithashtu për aparatet, kur ato përfshijnë si një pjesë të tërë ose si aksesori një pajisje mjekësore ose një pajisje mjekësore aktive transplantimi.
4. Kjo Rregullore përcakton kërkesat thelbësore në veprimtarinë e vendosjes në treg, lëvizjes së lirë dhe venies në shërbim të pajisjeve radio e të pajisjeve fundore të telekomunikacioneve në Republikën e Shqipërisë. Kjo Rregullore zbatohet për pajisjet e importuara, si dhe për ato që mund të prodhohen në Shqipëri.
5. Në këtë Rregullore është përkrahur gjithashtu procedura e njohjes së konformitetit për pajisjet radio.
6. Kjo Rregullore nuk zbatohet për pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacioneve të listuara në Aneksin 1.
7. Kjo Rregullore nuk zbatohet për pajisjet që përdoren ekskluzivisht për aktivitete që lidhen me sigurinë publike, mbrojtjen, sigurinë kombëtare dhe aktivitetet e shtetit në fushën e aplikimit të ligjit kundër krimit në Republikën e Shqipërisë.
8. Nuk duhet të pengohen apo krijohen pengesa për shfaqjen në panairë, ekspozita e në demonstrime të pajisjeve që nuk janë në përputhje me këto rregulla, me kushtin që një shënim i qartë dhe i dukshëm të tregojë që një pajisje e tillë nuk mund të vendoset në treg apo në shërbim pa u sjellë në përputhje me këtë Rregullore.

Neni 3

Perkufizime

Ne kuptimin e kesaj Rregulloreje termat e meposhtem kane keto kuptime:

1. "Direktiva R&TTE", eshte Direktiva 1999/5/EC (Mbi pajisjet radio dhe pajisjet fundore te telekomunikacioneve dhe njohjen reciproke te konformitetit te tyre).

2. "Kerkesat thelbësore", jane kerkesat e pergjithshme dhe specifike, te cilat duhet te plotesoje nje pajisje radio dhe pajisje fundore e telekomunikacioneve sipas Direktives R&TTE dhe Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr. 331, date 14.04.2011. Vleresimi i konformitetit eshte bazuar ne perputhjen e ketyre produkteve me nje komplet te kerkesave esenciale qe jane si me poshte:

i. Për të gjitha pajisjet brenda fushës së kësaj Rregulloreje aplikohen këto kërkesa thelbësore:

a) Mbrojtja e shëndetit dhe sigurimi i përdoruesit, si dhe i çdo personi tjetër, duke përfshirë edhe objektivat lidhur me kërkesat e sigurisë, por pa aplikimin e një vlere limit të tensionit, sipas rregullave të miratuara ne Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 369, datë 27.03.2008 "Për miratimin e rregullimit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve elektrike, të projektuara për përdorimin brenda disa kufijve të tensionit".

b) Kërkesat mbrojtëse lidhur me pajtueshmërinë elektromagnetike, sipas rregullave të miratuara me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.864, datë 18.06.2008 "Për miratimin e rregullimit teknik "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të përputhshmërisë elektromagnetike".

ii. Përveç kërkesave të përcaktuara në Piken i. më sipër, pajisjet radio duhen ndërtuar në mënyrë të tillë, që të përdorin efektivisht spektrin e përcaktuar për burimet e radiokomunikimi tokësore/hapësinore dhe orbitale, në mënyrë që të shmangen interferencat e dëmshme.

iii. Për aparatet brenda një klase të caktuar të pajisjeve ose aparatet e tipave të veçantë, mund të kërkohet përmbushja e kërkesave specifike të mëposhtme:

a) konstruktimin që të bashkëveprojnë me anë të rrjeteve me aparate të tjera dhe që të mund të lidhen në ndërfaqe të tipave të përshtatshëm në treg; dhe/ose

b) konstruktimin që të mos dëmtojnë rrjetin, funksionimin e tij, ose të mos keqpërdorë burimet e rrjetit, që mund të shkaktojnë një degradim të papranueshëm të shërbimit; dhe/ose

c) të përfshijnë masa mbrojtëse, për të siguruar që të dhënat personale dhe fshehtësia e përdoruesit dhe e abonentit të jenë të mbrojtura; dhe/ose

d) të mbështetin cilësi të caktuara, duke siguruar shmangien e mashtrimit; dhe/ose

e) të mbështetin cilësi të caktuara, duke siguruar akses në shërbimet e emergjencës; dhe/ose

f) të mbështetin cilësi të caktuara në mënyrë që të thjeshtohet përdorimi i tyre nga përdoruesit me aftësi të kufizuara.

3. "Njoftim", eshte procesi i njoftimit te AKEP-it mbi qellimin e subjekteve te ndryshme per te importuar ose vendosur ne treg pajisje radio. Ky njoftim kryhet vetem per pajisjet radio qe punojne ne breza frekuence jo te harmonizuara, me ane te aplikimit perkates per njohjen e konformitetit.

4. "Njohje te konformitetit", eshte nje procedure qe kryhet nga AKEP lidhur me njoftimin e derguar nga subjektet aplikante. Detyra e AKEP eshte te kontrolloje dokumentacionin e prezantuar dhe te konfirmoje njohjen e konformitetit te pajisjes radio, nese jane plotesuar te gjitha kerkesat e percaktuara ne kete Rregullore.

5. *"Futja ne treg"*, eshte nje aktivitet me ane te te cilit pajisja behet e pranishme per here te pare ne tregun Shqiptar, per t'u perhapur ne treg ose per t'u futur ne sherbim.

6. *"Brez frekuence i harmonizuar"*, eshte brezi i frekuencave, i cili në të gjithë ose në pjesën më të madhe të vendeve europiane është i parashikuar për përdorimin e pajisjeve radio me veçori të njëjta teknike (radiofrekuenca, modulimi, fuqia etj.).

7. *"Organizëm europian i notifikuar"*, është një organizëm i vlerësimit të konformitetit, i njohur nga Komisioni Europian dhe i regjistruar në faqen e tij zyrtare të internetit si një trupë kompetente për kryerjen e detyrave specifike të vlerësimit të konformitetit.

Neni 4 Vendosja ne treg

1. Vendosja e pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve në treg nënkupton vendosjen për herë të parë të këtyre pajisjeve në tregun Shqiptar, për shitje ose për përdorim të tyre, me pagesë ose jo.

2. Pajisjet radio dhe pajisjet fundore te telekomunikacioneve mund te vendosen ne treg ne qofte se pajtohen me kerkesat thelbësore te identifikuara ne Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.331 date 14.04.2011 dhe me te gjitha kerkesat e tij.

3. Pajisjet qe jane ne pajtim me kerkesat thelbësore, mund te vendosen ne treg nga nje person juridik ose fizik, i regjistruar per nje aktivitet te tille.

4. Fabrikuesi ose personi që vendos pajisjen në treg është përgjegjës për të siguruar që pajisja është në pajtim me këtë Rregullore.

5. Importuesi ose personi i cili sjell pajisjen nga jashtë Shqipërisë dhe e vendos atë në treg, mban të njëjtat përgjegjësi si fabrikuesi dhe duhet të sigurojë që produkti është në pajtim me këtë Rregullore.

6. Personi përgjegjës për vendosjen në treg të pajisjeve është i detyruar t'i japë përdoruesit instruksionin e përdorimit në gjuhën Shqipe, si dhe një fotokopje të origjinalit të deklaratës së konformitetit me kërkesat thelbësore.

7. Kur pajisja radio vendoset në treg, informacioni rreth qëllimit të përdorimit duhet të jetë i mjaftueshëm për t'u identifikuar në paketim dhe në instruksionet e përdorimit të pajisjes, si dhe të njoftojë përdoruesin me anë të identifikuesit të klasës së pajisjes, për kufizimet potenciale të përdorimit të pajisjes radio në vende të caktuara.

8. Kur pajisja vendoset në treg duhet të ketë të fiksuar shënjen përkatëse të konformitetit.

9. Kur pajisja fundore e telekomunikacionit vendoset në treg, informacioni duhet të jetë i mjaftueshëm për të identifikuar ndërfaqet në rrjetin publik të telekomunikacioneve, tek të cilët pajisja mund te lidhet. Për të gjitha pajisjet ky informacion duhet të shfaqet në mënyrë të dukshme.

10. Fabrikuesi, përfaqësuesi i autorizuar, importuesi ose personi përgjegjës për vendosjen në treg të pajisjeve radio, duhet të njoftojnë AKEP-in për njohjen e konformitetit përpara importimit dhe vendosjes në treg për herë të parë të pajisjeve radio që punojnë në breza frekuencash jo të harmonizuar.

Neni 5 Procedura e njohjes se konformitetit

1. Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), është autoriteti përgjegjës për njohjen e konformitetit për pajisjet radio. Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për pajisjet radio, që synohet të prodhohen, importohen, vendosen në treg, me përjashtim të pajisjeve radio që punojnë në frekuenca të harmonizuara.

2. Njoftimi për njohjen e konformitetit, duhet të kryhet nga çdo person fizik dhe juridik, nëse është publik ose privat, vendas ose i huaj. Subjekti aplikant është i detyruar të njoftojë AKEP-in, së paku katër javë përpara importimit dhe vendosjes së pajisjeve radio në tregun shqiptar.

3. Kjo procedurë është gjithashtu e detyrueshme për subjektet përdoruese të pajisjeve radio që punojnë në frekuenca jo të harmonizuara, të cilat për herë të parë importohen direkt prej tyre nga jashtë Shqipërisë.

4. Pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve janë të identifikuar në dy klasa:

i. Klasa 1 do t'i referohet pajisjeve, të cilat mund të vendosen në treg dhe të vendosen në shërbim pa kufizime. Për këtë klasë të pajisjeve, nuk është përcaktuar një identifikues i klasës së pajisjeve. Në këtë klasë janë të përfshira:

- pajisjet fundore të telekomunikacioneve që përfshihen në rrjetet fikse;
- pajisjet radio jotransmetuese (pajisjet vetëm marrëse);
- pajisjet radio, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti;
- radiotransmetuesit, që punojnë në breza të frekuencave të harmonizuara në Shqipëri dhe në vendet e Bashkimit Europian.

ii. Klasa 2 do t'i referohet pajisjeve për të cilat janë aplikuar kufizime gjatë vendosjes në treg ose vendosjes në shërbim. Për këtë klasë të pajisjeve është përcaktuar një identifikues i klasës së pajisjeve. Pajisja e kësaj klase duhet të shënohet me një simbol lajmëruar (një rreth me një pikëçuditëse brenda saj). Pajisja radio, e cila nuk i përket Klasës 1, përfshihet në Klasën 2.

5. AKEP-i harton një listë të pajisjeve, të cilat mund të importohen dhe të vendosen në treg pa kryer njoftimin dhe procedurën e njohjes së konformitetit. Kjo listë rishikohet periodikisht duke përfshirë në të kryesisht pajisje të Klasës 1 sipas përcaktimeve në faqet e internetit të EC/ERO (European Commission/European Radiocommunications Office). Lista e pajisjeve do të jetë e prezantuar nëpërmjet faqes zyrtare të AKEP-it në internet www.akep.al. Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për të gjitha pajisjet radio, që prodhohen, importohen, vendosen në treg dhe përdoren, me përjashtim të atyre rasteve kur AKEP-i nuk duhet të njoftohet.

6. Njoftimi është aksioni fillestar për ta bërë një pajisje radio të disponueshme për herë të parë në tregun shqiptar.

7. Formulari i njoftimit duhet të jetë sipas Aneksit 3 (në gjuhën Shqipe ose Angleze), bashkëlidhur me këtë Rregullorë, të cilat mund të sigurohen në internet në faqen zyrtare të AKEP-it www.akep.al.

8. Formulari i njoftimit duhet të përmbajë informacion për karakteristikat radio të pajisjes, në veçanti për brezat e frekuencave, hapësirën e kanalit, llojin e modulimit dhe fuqinë RF në dalje, si dhe numrin e identifikimit të organizmit europian të notifikuar, i cili është përfshirë në vlerësimin e konformitetit të pajisjes. AKEP nuk i ben publike informacionet e fituara gjatë procesit të njoftimit.

9. Njoftimi për njohjen e konformitetit mund të nënshkruhet vetëm nga personat e autorizuar për të marrë përgjegjësi në emër të subjektit.

- 10.** Formulari i njoftimit konsiderohet të jetë i plotësuar, kur të gjitha kërkesat lidhur me formën dhe përmbajtjen e tij janë plotësuar. Ky konsiderohet si momenti i fillimit të procesit të njohjes së konformitetit.
- 11.** Njoftimi i dërguar nga aplikanti dhe dokumenti i lëshuar për njohjen e konformitetit:
- nuk do të thotë aprovim i përdorimit të pajisjeve radio në territorin e Republikës së Shqipërisë;
 - nuk garanton lëshimin e një autorizimi për përdoruesin dhe për vendosjen në operim të pajisjes radio;
 - nuk e lehtëson aplikantin nga detyrimet e tij sipas kesaj Rregulloreje.
- 12.** Dokumentacioni bashkëngjitur me formularin e njoftimit duhet të jetë, si më poshtë:
- përshkrimi teknik dhe specifikimet teknike, sipas dokumentacionit të fabrikuesit, ose raportet e testimit;
 - deklarata e konformitetit e lëshuar nga fabrikuesi, dhe/ose opinionimi i organizmit europian të notifikuar, nëse ai është parashikuar nga procedurat e vlerësimit të konformitetit.
- 13.** Në procesin e njohjes së konformitetit duhet të merret gjithashtu në konsideratë Plani Kombëtar i Radiofrekuencave, duke refuzuar njohjen e konformitetit për pajisjet radio që përdorin breza radiofrekuence, të cilët në këtë plan janë përcaktuar për qëllime të tjera.
- 14.** Në bazë të njoftimit të marrë dhe dokumentacionit bashkëngjitur tij, AKEP-i pasi shqyrton nëse plotësohen konditat për importimin dhe/ose vendosjen në treg të pajisjes radio sipas kësaj Rregulloreje, konfirmon njohjen e konformitetit.
- 15.** Në rastin e mospërputhjes me kushtet e paraqitura në këtë Rregullore, AKEP-i informon subjektin aplikant, që pajisja perkatese radio nuk mund të përdoret në Republikën e Shqipërisë. Çdo refuzim për njohjen e konformitetit të pajisjes radio duhet të jetë i motivuar.
- 16.** AKEP-i mund të refuzojë aplikimin për njohje të konformitetit, nëse është e ndaluar vendosja e një pajisje të caktuar radio në tregun e Bashkimit Europian.
- 17.** Pajisja radio e parashikuar për të kryer procesin e njohjes së konformitetit, mund të importohet dhe vendoset në treg vetëm pas lëshimit të dokumentit përkatës që konfirmon njohjen e konformitetit.
- 18.** Vlefshmëria e njohjes së konformitetit është e kufizuar vetëm për tipin e pajisjes radio të njoftuar.
- 19.** Njohja e konformitetit nuk përfaqëson një certifikatë vlerësimi të konformitetit të pajisjes radio me kërkesat thelbësore.
- 20.** Njohja e konformitetit të pajisjeve radio mund të revokohet kur provohet shkelja e kërkesave thelbësore të specifikuara në deklaratën e konformitetit, të lëshuar nga fabrikuesi, ose kur është vërtetuar përdorimi i tij jo në pajtim me Planin Kombëtar të Radiofrekuencave dhe me specifikimet teknike të njoftuara nga subjekti aplikant.
- 21.** AKEP publikon dhe përditëson në faqen zyrtare www.akep.al listen e pajisjeve radio, për të cilat është lëshuar konfirmimi i njohjes së konformitetit.
- 22.** Përgjegjësia për sigurinë, funksionimin, cilësinë dhe besueshmërinë e pajisjeve radio sipas kërkesave thelbësore, për të cilat është lëshuar njohja e konformitetit, bie plotësisht mbi subjektet që e kanë marrë dokumentin e njohjes së konformitetit.

23. Konfirmimi i njohjes së konformitetit nga AKEP për pajisjet radio bëhet në gjuhën Shqipe ose Angleze, sipas modelit të paraqitur në Aneksin 4 të kesaj Rregulloreje.
24. Procesi i njohjes së konformitetit është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radio të aplikantit fillestar të njoftimit, me kusht që të jenë identike me atë që është njoftuar.
25. Njohja e konformitetit, e cila i lëshohet për herë të parë një subjekti aplikant, është e vlefshme edhe për çdo subjekt tjetër, i cili ka në zotërim pajisje radio të të njëjtit tip. Procesi i njoftimit është i vlefshëm për të gjitha pajisjet radio identike të të njëjtit tip, pavarësisht autorit të njoftimit.
26. Kur lëshohet konfirmimi i njohjes së konformitetit, AKEP pregatit faturen e adresuar tek aplikanti i njoftimit.
27. Nuk egziston një afat limit vlefshmerie për dokumentin e lëshuar të njohjes së konformitetit.
28. Për pajisjet e radiokomunikimit me përdorim dhe qëndrim të përkohshëm në Republikën e Shqipërisë, jo më shumë se tre muaj, AKEP-i në rastet e justifikuara mund të bëjë njohjen e konformitetit me procedurë të përshpejtuar.
29. Në përfundim të procedurës së njohjes së konformitetit, AKEP-i regjistron në bazën e të dhënave, tipin e pajisjes radio, parametrat përkatës dhe subjektin, i cili ka dërguar njoftimin.
30. Informacionet e fituara gjatë procesit të njohjes së konformitetit do të jenë të disponueshme për aktivitetet e AKEP-it në procesin e inspektimit, monitorimin e spektrit, investigimin e interferencave dhe në mbikqyrjen e tregut.

Neni 6

Vendosja në shërbim

1. Pajisjet që mbulohen nga kjo Rregullore vendosen në shërbim sipas qëllimit të parashikuar nga fabrikuesi vetëm kur ato plotësojnë kërkesat thelbësore dhe dispozitat e tjera përkatëse në këtë Rregullore.
2. Operatorët janë të detyruar të lidhin në rrjet vetëm pajisje radio, të cilat kanë kaluar procesin e njohjes së konformitetit.
3. Përdoruesi i pajisjeve është përgjegjës për përdorimin korrekt të tyre, sipas rregullave të percaktuara në këtë Rregullore.
4. Subjektet që punojnë në fushën e komunikimeve elektronike nuk mund të refuzojnë një kërkesë të arsyeshme për lidhjen e një pajisjeje fundore të telekomunikacioneve me ndërfaqet e përshtatshme mbi baza teknike, të cilat përputhen me kërkesat thelbësore.
5. AKEP-i mund të kufizojë vënien në shërbim të pajisjeve radio vetëm për shkaqe apo arsye në lidhje me përdorimin efektiv dhe të përshtatshëm të spektrit të radiofrekuencave, shmangien e interferencave të dëmshme ose në lidhje me çështje të shëndetit publik.
6. Në qoftë se AKEP konkludon që një pajisje e deklaruar në përputhje me kërkesat e Rregullores, shkakton dëmtime serioze të rrjetit të komunikimeve elektronike, interferenca të dëmshme ose interferenca në funksionimin e këtij rrjeti, autorizon operatorin të refuzojë lidhjen e pajisjes në rrjetin e tij, ta heqë nga lidhja atë, ose ta heqë nga përdorimi.
7. Në rast emergjence, një operator mund të heqë nga lidhja pajisjen, në qoftë se mbrojtja e rrjetit kërkon që pajisja të hiqet nga lidhja pa vonesë dhe, në qoftë se përdoruesit mund t'i

ofrohet pa vonesë dhe pa kosto një zgjidhje tjetër alternative. Në këtë rast, operatori duhet të informojë menjëherë AKEP-in.

8. Vlerat limit të fushës elektromagnetike, vlerat limit të fuqisë së rrezatuar, si dhe kushte të tjera, të cilat duhet të plotësohen nga pajisjet, si një burim i rrezatimit elektromagnetik të radiofrekuencave, duhet të jenë sipas vlerave të parashikuara në rregulloret e pajisjeve radio dhe pajisjeve fundore të telekomunikacioneve.

9. Përdoruesit e pajisjeve duhet t'u mundësojnë personave të autorizuar nga AKEP-i të kryejnë inspektime, matje dhe teste të nevojshme, me qëllim detektimin e burimeve të interferencës, të ofrojnë të dhëna dhe dokumentacionin e nevojshëm për kryerjen e inspektimeve, matjeve dhe testeve.

10. Në qoftë se nga inspektimi evidentohet, që pajisja shkakton interferencë mbi nivelin e lejuar, personat e autorizuar mund të kërkojnë nga përdoruesi i kësaj pajisje të eliminojë brenda një kohe të caktuar interferencën e evidentuar dhe të informojë AKEP-in për këtë.

11. Në qoftë se përdoruesi i pajisjeve, të cilat shkaktojnë interferencë, nuk eliminon interferencat e evidentuara në një kohë të përcaktuar, atëherë merren masat e parashikuara në Ligjin Nr. 9918, datë 19.05.2008.

Neni 7 Vleresimi i konformitetit

1. Fabrikuesi është përgjegjës për vleresimin e konformitetit të produktit të tij me kërkesat thelbësore, të përcaktuara në Nenin 3 në këtë Rregulloret.

2. Procedurat e vlerësimit të konformitetit sipas anekseve 2, 3, 4 dhe 5, të identifikuar në Direktiven R&TTE dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 14.04.2011 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vleresimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve””, duhet të përdoren për të demonstruar përputhjen e pajisjeve me kërkesat thelbësore.

3. Fabrikuesi i pajisjeve mund të zgjedhë një nga procedurat e vlerësimit të konformitetit, të përcaktuara në Tab.1 sipas anekseve të përcaktuara Piken 2 të këtij Neni.

4. Në fund të procedurës së vlerësimit të konformitetit, fabrikuesi harton një deklaratë të shkruar të konformitetit të pajisjes sipas kërkesave thelbësore.

Tipi i pajisjes	Procedura e vlerësimit teknik			
	Aneksi II	Aneksi III	Aneksi IV	Aneksi V
Pajisja fundore e telekomunikacioneve	X		X	X
Pjesët marrese të pajisjeve radio	X		X	X
Pajisja radio me aplikim të plote të standardeve të harmonizuara		X	X	X

Pajisja radio me aplikim te pjesshem ose jo te standardeve te harmonizuara			X	X
---	--	--	----------	----------

Tab. 1

**Neni 8
Vendosja e markimit CE të pajisjeve**

1. Pajisjet që janë në përputhje me kërkesat thelbësore mbajnë markimin CE. Markimi CE është një deklaram i fabrikuesit, që produkti është në përputhje me të gjitha kërkesat thelbësore dhe që procedurat perkatase të vlerësimit të konformitetit janë kryer.
2. Markimi CE dhe shenjat e tjera shtesë, duhet të jenë të paraqitura sipas rekomandimeve ne këte Regulllore. Përgjegjës për fiksimin e markimit CE është fabrikuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për vendosjen e pajisjes në treg.
3. Markimi CE duhet të shfaqet tek pajisja, në paketim dhe në manualin e përdorimit. Markimi CE duhet të fiksohet në mënyrë të dukshme, të lexueshme dhe të mos fshihet.
4. Në qoftë se fabrikuesi është konsultuar me një organ të autorizuar për vlerësimin e konformitetit, numri i identifikimit të organit të autorizuar (NBnr) duhet të shtohet tek markimi CE. Numri i identifikimit të organit të autorizuar përbëhet nga një sekuencë prej katër numrash. Organet e akredituara sipas Direktives R&TTE dhe numri i tyre i identifikimit jane te paraqitura ne website-in e Komisionit European.
5. Në qoftë se ka kufizime në përdorimin e pajisjes radio, kjo duhet treguar me anë të një simboli lajmërues së bashku me markimin CE dhe numrin e identifikimit të organit të autorizuar, si në Fig. 1.



Markimi CE

Numri i identifikimit
te organit te autorizuar
(NBnr)

Simboli
Lajmerues

Fig. 1

6. Pajisja duhet të identifikohet nga fabrikuesi me anë të tipit, grupit dhe/ose numrit serial, si dhe me anë të emrit të fabrikuesit ose të personit që është përgjegjës për vendosjen e aparatit në treg.
7. Pajisjet që përputhen me kërkesat thelbësore duhet të mbajnë shenjën e markimit CE, siç përcaktohet në Aneksin 2 ne kete Rregulllore.
8. Pajisjet radio që punojnë në breza të frekuencave, përdorimi i të cilave nuk është i harmonizuar, përveç markimit CE, i vendoset edhe një shenjë lajmëruese, siç përcaktohet në Aneksin 2.

**Neni 9
Mbikqyrja e tregut**

1. AKEP-i është autoriteti përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit.
2. Aktiviteti i mbikëqyrjes së tregut kryhet në përputhje me Ligjin Nr. 9779.
3. Objektivat e mbikëqyrjes së tregut përfshijnë:
 - i. të sigurojë që pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit në treg përputhen me kërkesat thelbësore në këto Rregullore;
 - ii. të kontrollojë nëse janë plotësuar kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore;
 - iii. të kontrollojë që fiksimi dhe përdorimi i markimit CE është korrekt dhe, nëse principet lidhur me shenjat e tjera shtesë janë respektuar.
4. Deklaratat e konformitetit duhet të jenë të disponueshme sa herë që ato të kërkohen nga autoritetet e inspektimit. Për më tepër, çdo produkt duhet të jetë i shoqëruar deri te përdoruesi me deklaratën e konformitetit.
5. Në rast se pajisjet e vendosura në treg paraqiten jo në konformitet, me kushtet e përcaktuara në këtë Rregullore, atëherë AKEP-i merr masa në përputhje me legjislacionin në fuqi.
6. Pronari i pajisjeve radio ose pajisjeve fundore të telekomunikacioneve nuk ka të drejtë të pengojë inspektimin dhe është i detyruar të bashkëpunojë dhe të ofrojë të gjithë informacionin e nevojshëm sa herë që kërkohet një gjë e tillë.
7. Nëse gjatë mbikëqyrjes nevojitet ekspertizë e veçantë, atëherë mund të merren edhe ekspertë të tjerë në fusha të caktuara.
8. AKEP-i ka autoritetin të ndalojë, të kufizojë ose të heqë nga përdorimi pajisjet radio dhe pajisjet fundore të telekomunikacionit, që shkaktojnë ose ka mundësi të shkaktojnë interferenca të dëmshme.
9. Inspektorët e AKEP-it pajisen me dokument të posaçëm të identifikimit. Për të verifikuar zbatimin e kësaj Rregulloreje, ata kryejnë inspektim në mjediset ku subjekti zhvillon veprimtarinë. Ky inspektim mund të kryhet gjithashtu, pa e njoftuar paraprakisht subjektin përkatës.

Neni 10 Pagesat

1. Pagesa për subjektet fabrikuese dhe tregtuese të pajisjeve radio, të cilat fitojnë njohjen e konformitetit, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike.
2. Pagesa për subjektet jotregtuese ose subjektet përdoruese të pajisjeve radio, të cilat fitojnë njohjen e konformitetit, përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave me propozim të ministrit përgjegjës për komunikimet elektronike.

Neni 11. Dispozita kalimtare

1. Për pajisjet radio, të cilat kanë kaluar në procedurën e miratimit të tipit bazuar në ligjin Nr. 8618, datë 14.06.2000 “Për telekomunikacionet në Republikën e Shqipërisë” i shfuqizuar, dhe rregulloren e ERT “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve”, nuk është e nevojshme që subjektet e interesuara të njoftojnë në AKEP, kur pajisjet radio nuk kanë ndryshime në specifikimet teknike, apo nuk ka ndryshime në Planin Kombëtar të Radiofrekuencave, si dhe në përcaktimet e radorregulloreve të ITU-së e dokumentet përkatëse të CEPT/ERO.

2. AKEP-i publikon listën e pajisjeve radio të parashikuara në Pikën 5 të Nenit 5, për të cilat nuk duhet të kryhet procedura e njohjes së konformitetit. Kjo liste rishikohet periodikisht.

Neni 12.
Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të saj në faqen zyrtare të AKEP www.akep.al.




PAJISJET QË NUK MBULOHEN NGA KY RREGULL

1. Pajisja radio që përdoret nga radioamatorët (sipas përcaktimit në pikën 53 të nenit 1 të radorregulloreve të ITU-së), përveç se kur pajisja është e mundshme për t'u tregtuar. Pjesët përbërëse të komponentëve të montuara nga radioamatorët dhe pajisje të tregtueshme, të modifikuara dhe të përdorura prej radioamatorëve, që nuk konsiderohen si pajisje të mundshme për t'u tregtuar.
2. Pajisjet e marinës.
3. Instalimet kabllore dhe me tel.
4. Pajisja radiomarrëse që ka për qëllim përdorimin vetëm për shërbimet e marrjes së transmetimeve audio dhe TV.
5. Pajisje të caktuara që përdoren në aviacionin civil.
6. Pajisje të caktuara për menaxhimin e trafikut ajror.

Shenim: Kjo liste i referohet Direktives RTTE.

**SHENIMI I PAJISJEVE RADIO
DHE PAJISJEVE FUNDORE TE TELEKOMUNIKACIONEVE
SIPAS PROCEDURAVE TE VLERESIMIT TE KONFORMITETIT**

Pajisjet fundore te telekomunikacioneve (jo radio)	
Procedura e konformitetit	Shenimi
Aneksi II (Kontrolli i brendshem i prodhimit)	CE
Aneksi IV (File i ndertimit teknik) ose Aneksi V (Siguria e plote e cilesise)	CE NBnr

Pajisjet radio		
Procedura e konformitetit	Brezi i frekuencave	
	i harmonizuar	jo i harmonizuar
Aneksi III Kontrolli i brendshem i prodhimit dhe testet specifike te pajisjes (perdorimi i standardeve te harmonizuara)	CE CE NBnr	CE  CE NBnr 
Aneksi IV File i ndertimit teknik ose Aneksi V Siguria e plote e cilesise	CE NBnr	CE NBnr 

Shenim: Emertimet Aneksi I, II, III, IV dhe V i referohen VKM Nr. 331, datë 14.04.2011 “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve”.

REPUBLIC OF ALBANIA
ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS AUTHORITY
 Rruga “Reshit Çollaku” 43, Tirana, Albania
 Fax +355 42 259 106
 Web site www.akep.al
 E-mail info@akep.al

NOTIFICATION FORM OF RADIO EQUIPMENT

ON IMPORTING AND/OR PLACING THE RADIO EQUIPMENT ON THE MARKET

The radio equipment must be in compliance with the essential requirements of Council Ministers Act No. 331 date 14.04.2011 “On the essential requirements and conformity assessment of radio and telecommunications terminal equipment”. AKEP has the responsibility to confirm the recognition of conformity. This process should be initiated before the importing, placing on the market or putting the radio equipment into service.

The Company _____ presented by Mr/Mrs _____
that carrying out activities in the field of :

manufacturing importing placing on the market putting into service

of radio equipment, notifies AKEP to obtain the conformity recognition for the equipment with the following data:

1. The responsible company for obtaining the conformity recognition on radio equipment.

The responsible company, means the manufacturer, his authorized representative and any other person who imports and/or places the radio equipment on the market.

Company/Name :	
Contact Person :	
Address :	
Telephone :	
Fax :	
E-mail :	

2. The manufacturer of equipment

Company/Name :	
Address :	

Telephone :	
Fax :	
E-mail :	

3. Information on the notified radio equipment

Equipment category	
Type of equipment	
Trade name	

4. Intended use / purpose of equipment

This should be a brief description of the intended use or purpose of the equipment, as defined by the manufacturer.

--

5. The main technical specifications of equipment

	Information	Response
	Frequency bands	
	Operating frequency/frequencies	
	Type of modulation	
	Number of channels	
	Channel spacing	
	Class of emission	
	Max output power or radiated power	
	Duty cycle	
	Channel access protocol	
	Mode of operation (simplex/duplex)	
	Maximal data rate	
	Type of antenna	
	Power supply	
	Additional information	

6. Information on conformity assessment with essential requirements

	Information	Response
	Conformity assessment procedure applied (according to Council Ministers Act "On the essential requirements and conformity assessment of radio and telecommunications terminal equipment")	<input type="checkbox"/> Annex II <input type="checkbox"/> Annex IV <input type="checkbox"/> Annex III <input type="checkbox"/> Annex V
	Harmonized standards	

	Notified body identification number: (Number or numbers of notified bodies involved in the conformity assessment procedure)	
--	---	--

7. The declarations of conformity attached with the application form

The manufacturer and/or notified body have full responsibility to ensure that the equipment is in the conformity with the requirements of Council Ministers Act No. 331 date 14.04.2011 “On the essential requirements and conformity assessment of radio and telecommunications terminal equipment”.

The Declaration of Conformity by the manufacturer

The Opinion on Conformity by the notified body

Declaration

We are aware that this notification doesn't ensure the ability to put into service the notified equipment in the Republic of Albania. The use of this equipment may be restricted according to other provisions.

No legal claim to a frequency assignment can be derived from this notification.

I hereby declare that I am entitled to sign this notification and that the information supplied is correct and complete.

Place and date of notification:

Name, Family Name:

Signature and stamp of responsible company or authorized company:

In case the notification is submitted by an authorized company, it is necessary an authorization submitted by him.

8. Additional information on using of notified radio equipment

	Country	Current using	Planned using	Remarks
	Austria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Belgium	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Bulgaria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Cyprus	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Czech Republic	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Denmark	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Estonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Finland	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	France	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Germany	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Greece	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Hungary	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Iceland	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Ireland	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Italy	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Latvia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Lithuania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Luxembourg	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Malta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	The Netherlands	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Norway	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Poland	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Portugal	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Romania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Slovakia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Slovenia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Spain	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Sweden	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Switzerland	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	United Kingdom	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

Here should be specified countries where radio equipment was used or where is planned using in the future.

Attached with notification should be:

- 1. Technical description and technical specifications according the manufacturer documentation, or test reports;**
- 2. Declaration of Conformity issued by manufacturer according to Council Ministers Act “On the essential requirements and conformity assessment of radio and telecommunications terminal equipment” and/or opinion of notified body, if it is foreseen to involve in the conformity assessment procedures.**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

Rruga "Reshit Çollaku" nr.43, Tiranë, Shqipëri
 Fax +355 42 259 106
 Web site www.akep.al
 E-mail info@akep.al

FORMULAR PER NJOFTIMIN E PAJISJEVE RADIO

MBI IMPORTIMIN DHE/OSE VENDOSJEN NE TREG TE PAJISJEVE RADIO

Pajisja radio duhet të jetë në pajtim me kërkesat thelbësore të vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 14.04.2011 "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve". AKEP-i ka përgjegjësinë për të konfirmuar njohjen e konformitetit. Ky proces duhet të fillojë përpara importimit, vendosjes në treg ose futjes në shërbim të pajisjes radio.

Subjekti _____, përfaqësuar nga Z/Znj _____
 që zhvillon aktivitet në fushen e :

prodhimit importimit vendosjes në treg futjes në përdorim

të pajisjeve radio, njofton AKEP për të fituar njohjen e konformitetit për pajisjen me të dhënat e mëposhtme:

1. Subjekti përgjegjës për të fituar njohjen e konformitetit të pajisjes radio

Subjekt përgjegjës do të quajmë fabrikuesin, përfaqësuesin e tij të autorizuar dhe çdo person tjetër i cili importon dhe/ose vendos në treg pajisje radio.

Subjekti/Emri :	
Personi i kontaktit :	
Adresa :	
Telefon :	
Fax :	
E-mail :	

2. Fabrikuesi i pajisjes

Kompania/Emri :	
Adresa:	

Telefon :	
Fax :	
E-mail :	

3. Informacion mbi pajisjen radio te njoftuar

Kategoria e pajisjes	
Tipi i pajisjes	
Marka e regjistruar	

4. Qëllimi i përdorimit te pajisjes

Ketu duhet të jetë një përshkrim i shkurtër i qëllimit të përdorimit të pajisjes, sic është përcaktuar nga fabrikuesi.

--

5. Specifikimet teknike kryesore të pajisjes

	Informacion	Përgjigje
	Brezi i frekuencave	
	Frekuenca e punës/frekuencat	
	Lloji i modulimit	
	Numri i kanaleve	
	Hapësira e kanalit	
	Klasa e emisionit	
	Fuqia max në dalje ose fuqia e rrezatuar	
	Duty cycle	
	Channel access protocol	
	Mënyra e operimit (simplex/duplex)	
	Maximal data rate	
	Tipi i antenës	
	Tensioni i ushqimit	
	Informacion shtesë	

6. Informacion mbi vlerësimin e konformitetit me kërkesat thelbësore

	Informacion	Përgjigje
	<p>Procedura e aplikuar e vlerësimit te konformitetit (sipas vendimit te Keshillit të Ministrave ”Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve)</p>	<input type="checkbox"/> Aneksi II <input type="checkbox"/> Aneksi IV <input type="checkbox"/> Aneksi III <input type="checkbox"/> Aneksi V
	Standardet e harmonizuara	

	Numri i identifikimit te organit te autorizuar: (Numri ose numrat e organeve te autorizuar qe jane te perfshira ne proceduren e vleresimit te konformitetit)	
--	--	--

Shenim: Emertimet Aneksi I, II, III, IV dhe V i referohen VKM Nr. 331, datë 14.04.2011 “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve”.

7. Deklaratat e konformitetit që janë bashkëngjitur me njoftimin

Fabrikuesi dhe/ose organi i autorizuar kanë përgjegjësinë e plotë për të siguruar që pajisja është në konformitet me kërkesat e vendimit te Këshillit të Ministrave Nr. 331, datë 14.04.2011 “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve”.

Deklarata e fabrikuesit për konformitetin

Opinionit i organit të autorizuar për konformitetin

Deklarim

Jemi të vetëdijshëm që ky njoftim nuk na siguron mundësinë e futjes në shërbim në Republikën e Shqipërisë të pajisjes së njoftuar. Përdorimi i kësaj pajisje mund të jetë i kufizuar sipas dispozitave të tjera.

Asnjë pretendim zyrtar për caktimin e një frekuence nuk mund të vijë si rrjedhim i këtij njoftimi. Nëpërmjet kësaj deklarate ju vemë në dijeni që unë jam caktuar të nënshkruaj këtë njoftim dhe që informacioni i paraqitur këtu është korrekt dhe i plotë.

Vëndi dhe data e njoftimit:

Emri dhe mbiemri:

Nënshkrimi dhe vula e subjektit përgjegjës ose e subjektit te autorizuar:

Në rast se njoftimi paraqitet nga një subjekt i autorizuar, atëhere është e nevojshme të paraqitet një autorizim nga ana e tij.

8. Informacioni shtesë mbi përdorimin e pajisjes radio të njoftuar

	Vëndi	Përdorimi aktual	Përdorimi i planifikuar	Vërejtje
	Austria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Belgjika	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Bullgaria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Qipro	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Republika Ceke	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Danimarka	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Estonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Finlanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Franca	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Gjermania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Greqia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Hungaria	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Islanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Irlanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Italia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Letonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Lituania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Luksemburgu	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Malta	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Hollanda	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Norvegjia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Polonia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Portugalia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Rumania	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Slovakia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Slovenia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Spanja	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Suedia	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Zvicra	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	
	Mbretëria e Bashkuar	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	

Këtu duhet të jenë të specifikuar vendet ku pajisja radio është përdorur ose është planifikuar për t'u përdorur në të ardhmen.

Bashkëngjitur me njoftimin duhet të jenë:

1. Përshkrimi teknik dhe specifikimet teknike sipas dokumentacionit të fabrikuesit, ose raportet e testimit;
2. Deklarata e Konformitetit lëshuar nga fabrikuesi sipas vendimit të Keshillit të Ministrave "Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve" dhe/ose opinionit të organit të autorizuar, nëse ky është parashikuar të përfshihet në procedurën e vlerësimit të konformitetit.



ANNEX 4

REPUBLIC OF ALBANIA
ELECTRONIC AND POSTAL COMMUNICATIONS AUTHORITY

CONFIRMATION OF CONFORMITY RECOGNITION
FOR RADIO EQUIPMENT

No. _____ dt. _____

With respect to Council Ministers Act No. 331 dated 14.04.2011 "On the approval of Technical Rule "On essential requirements and conformity assessment of radio and telecommunications terminal equipment"", and based on the notification dated _____ presented by the company _____ (Address: _____), is required the conformity recognition for the following equipment :

- **Equipment category :** _____
- **Type of equipment :** _____
- **Manufacturer :** _____
- **Trade mark :** _____
- **Function offered** (short description) : _____
- **Main technical specifications :**

- **Manufacturer's statement and/or notified body opinion for conformity with essential requirements :**

*Electronic and Postal Communications Authority (AKEP)
confirm the recognition of conformity and gives to the company*

*the right to import and/or place the above type of radio equipment
on the market in Republic of Albania.*

The CE marking and other additional markings must be presented in radio equipment according to this technical rule.

CHAIRMAN

(Emri, Mbiemri)

(Firma dhe Vula)



ANEKSI 4

REPUBLIKA E SHQIPERISE
AUTORITETI I KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE DHE POSTARE

KONFIRMIM PER NJOHJEN E KONFORMITETIT
PER PAJISJEN RADIO

Nr. _____ dt. _____

Mbeshtetur ne vendimin e Keshillit te Ministrave Nr. 331 date 14.04.2011 "Per miratimin e rregullit teknik "Per kerkesat thelbesore dhe vleresimin e konformitetit te pajisjeve radio dhe fundore te telekomunikacioneve"" dhe bazuar ne njoftimin e dates _____ prezantuar nga subjekti _____ (Adresa: _____), eshte kerkuar njohja e konformitetit te pajisjes radio te meposhtme:

- **Kategoria e pajisjes :** _____
- **Tipi i pajisjes :** _____
- **Fabrikuesi :** _____
- **Marka e rregjistruar :** _____
- **Funksioni i ofruar** (pershkrim i shkurter) : _____
- **Karakteristikat kryesore teknike:**

- **Deklarata e fabrikuesit dhe/ose opinionimi i organit te akredituar per konformitet me kerkesat thelbesore :**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)
konfirmon njohjen e konformitetit dhe i jep subjektit

te drejten per te importuar dhe/ose vendosur tipin e mesiperme te pajisjes radio ne tregun e Republikes se Shqiperise.

Shenja CE dhe shenjat e tjera shtese duhet te jene te paraqitura ne pajisjen radio sipas ketij rregulli teknik.

K R Y E T A R I

(Emri, Mbiemri)

(Firma dhe Vula)

**Përfundimet e këshillimit publik të
Rregullores “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe
njohjen e konformitetit të tyre”**

Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare – AKEP, paraqet përfundimet e këshillimit publik për dokumentin **Rregullore “Për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve dhe njohjen e konformitetit të tyre”** e miratuar për këshillim publik me Vendimin **Nr.1924, datë 30.04.2012** të Këshillit Drejtues.

Në adresën zyrtare të AKEP kanë ardhur opinionet e mëposhtme:

- I.** Operatori A
- II.** Operatori B

AKEP i ka studjuar me kujdes opinionet e dërguara nga këto kompani dhe më poshtë paraqet qëndrimin për secilin nga komentet dhe sugjerimet.

I. Operatori A

Sugjeron si më poshtë:

1. Neni 1 “Fusha e zbatimit”, Paragrafi 1, përcakton subjektet që kanë detyrimin të zbatojnë këtë Rregullore. Ndërkohë, në Paragrafin 25 të Nenit 5 thuhet që njohja e konformitetit e lëshuar për herë të parë nga një subjekt aplikant, është e vlefshme për çdo subjekt tjetër. Do të sugjerohet që në shtesë të kishte definicione që të qartësonin se cili prej subjekteve e ka këtë detyrim si fillim.

Komenti i AKEP: Ky problem trajtohet në paragrafët 2.1 dhe 5.25 të dokumentit të publikuar për konsultim si më poshtë:

2.1 Kjo Rregullore zbatohet nga fabrikuesit, përfaqësuesit e autorizuar të fabrikuesve, subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në tregun shqiptar dhe nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike (kur bletja bëhet prej tyre jashtë tregut Shqiptar).

5.25 Njohja e konformitetit, e cila i lëshohet për herë të parë një subjekti aplikant, është e vlefshme edhe për çdo subjekt tjetër, i cili ka në zotërim pajisje radio të të njëjtit tip.

Ne mendojmë se nuk është e nevojshme që të përcaktohen kritere të tjera për subjektet që e kanë të detyrueshme marrjen për herë të parë të konfirmimit për njohjen e konformitetit. Një gjë të tillë e përcaktojnë kërkesat e tregut.

Megjithatë në Paragrafin 2.1 propozojmë që të bëhet një saktësim për subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në treg, si më poshtë:

2.1 Kjo Rregullore zbatohet nga fabrikuesit, përfaqësuesit e autorizuar të fabrikuesve, subjektet përgjegjëse për vendosjen e pajisjeve në tregun shqiptar (importuesit dhe/ose tregtuesit) dhe nga operatorët e rrjeteve të komunikimeve elektronike (kur bletja bëhet prej tyre jashtë tregut Shqiptar).

Operatori A:

2. Në Nenin 5 “Procedura e njohjes së konformitetit” thuhet që njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për pajisjet radio që synohen të prodhohen, importohen, vendosen në treg, me përjashtim të pajisjeve radio që punojnë në frekuenca të harmonizuara. Mendojmë që është i nevojshëm një informacion më i qartë lidhur me frekuencat të cilat konsiderohen të harmonizuara, sepse kompania jonë deri tani ka kryer procedurat e njohjes së konformitetit për të gjitha pajisjet radio të përdorura në shërbimin e levizshëm (3G, GSM) dhe shërbimin fikse (lidhjet fikse). A konsiderohen të harmonizuara brezat GSM dhe 3G, apo dhe brezat e përcaktuara në Planin Kombëtar të Radiofrekuencave për shërbimin fikse? Për këtë arsye mendojmë se është i nevojshëm listimi i pajisjeve të cilat përdoren në funksion të shërbimeve të përcaktuara në PKRF për përdorim të frekuencave të harmonizuara.

Komenti i AKEP: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.331, datë 14.4.2011 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”” përcakton:

13.2 Brënda tre muajve nga hyrja në fuqi e këtij rregulli teknik, AKEP-i publikon listën e pajisjeve të parashikuara në Paragrafin 5.6 për të cilat nuk duhet të kryhet procedura e njohjes së konformitetit.

Kjo detyrë është kryer nga AKEP, dhe lista e pajisjeve radio që përjashtohen nga kryerja e procedurës së njohjes së konformitetit është publikuar në faqen tonë të internetit. Në këtë listë janë përcaktuar aplikimet dhe brezat e tyre të frekuencave, për të cilat nuk është e nevojshme që të njoftohet AKEP për njohjen e konformitetit. Në këtë listë është pasqyruar edhe adresa përkatëse e internetit sipas ECO (European Communications Office), në të cilën janë përcaktuar edhe treguesit teknik të këtyre aplikimeve.

Njohjet e konformitetit të kryera deri më sot nga operatori A nuk janë të përfshira në listën e pajisjeve që janë të përjashtuara nga procesi i njohjes së konformitetit dhe të publikuar nga AKEP. Lidhur me pyetjen nëse konsiderohen të harmonizuara aplikimet në brezat GSM dhe 3G, lista bazuar në rekomandimet e ECO përcakton deri më sot, se vetëm терминаlet e përdoruesve fundor GSM përfshihen në këtë listë. Megjithatë, rishikimi i kësaj liste do të jetë një proces në vazhdim.

Opinionin ynë është që të ruhen ato formulime që janë edhe në dokumentin e paraqitur për këshillim publik si më poshtë:

5.5 AKEP-i harton një listë të pajisjeve, të cilat mund të importohen dhe të vendosen në treg pa kryer njoftimin dhe procedurën e njohjes së konformitetit. Kjo listë rishikohet periodikisht duke përfshirë në të kryesisht pajisje të Klasës 1 sipas përcaktimeve në faqet e internetit të EC/ERO (European Commission/European Radiocommunications Office). Lista e pajisjeve do të jetë e prezantuar nëpërmjet faqes zyrtare të AKEP-it në internet www.akep.al. Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për të gjitha pajisjet radio, që prodhohen, importohen, vendosen në treg dhe përdoren, me përjashtim të atyre rasteve kur AKEP-i nuk duhet të njoftohet.

Operatori A:

3. Në Nenin 5, Paragrafi 4, Pika i., bëhet një përcaktim i Klases 1 e cila u referohet pajisjeve të cilat vendosen në treg dhe në shërbim pa kufizim. Në Paragrafin 5 të këtij Neni flitet për listën e publikuar nga AKEP, për të cilën thuhet që përfshin kryesisht pajisje të Klasës 1. Ky dokument nuk bën të njohur kush janë pajisjet e tjera përveç atyre të Klasës 1, që përfshihen në listën e pajisjeve për të cilat nuk ka nevojë të ndiqen procedurat e njohjes së konformitetit.

Komenti i AKEP: Në fund të listës së pajisjeve radio, për të cilat nuk është e nevojshme kryerja e procedurës së njohjes së konformitetit, janë evidentuar edhe disa pajisje të Klasës 2, për të cilat një proces i tillë është i përjashtuar, sipas përcaktimeve të EC/ECO (European Commission/European Communications Office). Për këto pajisje janë bërë edhe shënimet përkatëse plotësuese në fund të listës së hartuar.

Ne mendojmë që të mos ndryshojnë formulimet në dokumentin e publikuar.

Operatori A:

4. Nisur nga Neni 8, Paragrafi 8 dhe Aneksi 2, bashkëngjitur dokumentit, kuptohet që markimin CE duhet ta kenë të gjitha pajisjet radio që punojnë në breza frekuence të harmonizuara. Nënkupton kjo që pajisjet që kanë markimin CE nuk kane nevojë për procedurën e njohjes së konformitetit? Nëse po, mendojmë se është e nevojshme të theksohet kjo në rregullore.

Komenti i AKEP: Formulimet për markimin CE në dokumentin e publikuar janë bërë në përputhje me rekomandimet që jepen për Direktivën 1999/5/EC. Markimi CE është një deklaram i fabrikuesit, që produkti është në përputhje me të gjitha kërkesat thelbësore dhe që procedurat përkatëse të vlerësimit të konformitetit janë kryer. Në dokument është përcaktuar që pajisjet radio të përjashtuara nga detyrimi për kryerjen e procedurës së njohjes së konformitetit janë sipas listës përkatëse të hartuar nga AKEP bazuar në publikimet e ECO (European Communications Office) dhe në Planin Kombëtar të Radio Frekuencave.

Në materialin e publikuar është përcaktuar si më poshtë:

8.7 Pajisjet që përputhen me kërkesat thelbësore duhet të mbajnë shenjën e markimit CE, siç përcaktohet në Aneksin 2 në këtë Rregullore.

8.8 Pajisjet radio që punojnë në breza të frekuencave, përdorimi i të cilave nuk është i harmonizuar, përveç markimit CE, i vendoset edhe një shenjë lajmëruese, siç përcaktohet në Aneksin 2.

Ne mendojmë se këto paragrafe janë të mjaftueshme për të sqaruar direkt këtë pyetje, dhe mendojmë që të ruhen ato formulime që janë edhe në dokumentin e paraqitur për këshillim publik.

II. Operatori B

Sugjeron si më poshtë:

1. Operatori B konsideron se ka duplikim të plotë midis VKM dhe Rregullores së propozuar nga AKEP. AKEP mund të propozojë një akt rregullator për këtë fushë vetëm nëse duhet të parashikojë në këtë akt rregullator të tij sqarimin e mëtejshëm të kërkesave të parashikuara në VKM 331/2011 dhe jo të përsërisë të njëjtat dispozita me VKM 331/2011, duke krijuar konfuzion për vlerën juridike të kësaj Rregulloreje. Megjithatë është e diskutueshme nga pikëpamja juridike nëse një akt i një organi rregullator mund të detajtojë rregullime të vendosura me akte të Këshillit të Ministrave, sic është VKM.

Komenti i AKEP: Ky dokument plotëson kuadrin rregullator të AKEP me përcaktimet eksplicite në zbatim të një akti me fuqi nënligjore sic është VKM Nr.331, datë 14.4.2011 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve””. Ligji Nr. 9918, dhe Akti i Këshillit të Ministrave i nxjerrë në zbatim të tij e ka përcaktuar AKEP përgjegjës për njohjen e konformitetit për pajisjet radio të telekomunikacioneve që punojnë në breza frekuencash jo të harmonizuar si dhe përgjegjës për mbikëqyrjen e tregut për pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacionit.

Natyra ligjore e kësaj rregullore është tipike e një akti administrativ tekniko-juridik i cili ka në përmbajtje rregulla të specifikuar të cilat detajojnë hollësisht marrëdhënie juridiko-teknike për të cilat është shprehur me parë një akt tjetër me fuqi nënligjore (VKM 331).

Operatori B:

2. VKM 331/2011 parashikon në paragrafin 5.5 se disa pajisje të Klasës 1, të tilla si: pajisjet fundore të telekomunikacioneve që i bashkëngjiten rrjeteve fikse; pajisjet radio jotransmetuese; pajisjet radio, si psh. Telefonat GSM, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti, lejohet të importohen dhe vendosen në treg pa njoftim në AKEP dhe pa qënë e nevojshme të përfshihen në Listën e pajisjeve të përjashtuara nga procedura e njohjes së konformitetit, të publikuar nga AKEP në përputhje me paragrafin 5.6 të VKM 331/2011.

Ndërkohë Rregullorja e AKEP është formuluar në mënyrë të tillë që, duke mos parashikuar përjashtimin e përgjithshëm të vendosur në paragrafin 5.5 të VKM 331/2011, përjashton nga procesi i njoftimit dhe i njohjes së konformitetit vetëm ato pajisje të parashikuara në Listën e publikuar të AKEP.

Kompania jonë e kundërshton një ndryshim të tillë. Nga pikëpamja e hierarkisë së akteve juridike, VKM 331/2011 qëndron mbi Rregulloren e nxjerrë nga AKEP, për pasojë kjo mangësi e draft Rregullores e bën atë në kundërshtim me VKM 331/2011 e për pasojë juridikisht të pavlefshme.

Komenti i AKEP: Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.331, datë 14.4.2011 “Për miratimin e Rregullit Teknik “Për kërkesat thelbësore dhe vlerësimin e konformitetit të pajisjeve radio dhe fundore të telekomunikacioneve”” përcakton:

5.5 Në Republikën e Shqipërisë mund të importohen dhe të vendosen në treg pa njoftim, pajisjet, të cilat përfshihen në grupet e pajisjeve, si më poshtë:

- pajisjet fundore të telekomunikacioneve që i bashkëngjiten rrjetave fikse;
- pajisjet radio jotransmetuese;
- pajisjet radio, si p.sh., telefonat GSM, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti.

5.6 AKEP-i harton një listë të pajisjeve, të cilat mund të importohen dhe të vendosen në treg pa kryer njoftimin dhe procedurën e njohjes së konformitetit. Kjo listë rishikohet periodikisht duke përfshirë në të pajisje të Klasës 1, lista e pajisjeve do të jetë e prezantuar nëpërmjet faqes zyrtare të AKEP-it në internet: www.akep.al.

Në dokumentin e draft Rregullores së paraqitur për këshillim publik përcaktohet:

5.4 Pajisjet radio dhe fundore të telekomunikacioneve janë të identifikuara në dy klasa:

i. Klasa 1 do t'i referohet pajisjeve, të cilat mund të vendosen në treg dhe të vendosen në shërbim pa kufizime. Për këtë klasë të pajisjeve, nuk është përcaktuar një identifikues i klasës së pajisjeve. Në këtë klasë janë të përfshira:

- pajisjet fundore të telekomunikacioneve që përfshihen në rrjetet fikse;
- pajisjet radio jotransmetuese (pajisjet vetm marrëse);
- pajisjet radio, të cilat transmetojnë vetëm nën kontrollin e një rrjeti;
- radiotransmetuesit, që punojnë në breza të frekuencave të harmonizuara në Shqipëri dhe në vendet e Bashkimit Europian.

ii. Klasa 2 do t'i referohet pajisjeve për të cilat janë aplikuar kufizime gjatë vendosjes në treg ose vendosjes në shërbim. Për këtë klasë të pajisjeve është përcaktuar një identifikues i klasës së pajisjeve. Pajisja e kësaj klase duhet të

shënohet me një simbol lajmërues (një rreth me një pikëçuditëse brënda saj). Pajisja radio, e cila nuk i përket Klasës 1, përfshihet në Klasën 2.

5.5 AKEP-i harton një listë të pajisjeve, të cilat mund të importohen dhe të vendosen në treg pa kryer njoftimin dhe procedurën e njohjes së konformitetit. Kjo listë rishikohet periodikisht duke përfshirë në të kryesisht pajisje të Klasës 1 sipas përcaktimeve në faqet e internetit të EC/ERO (European Commission/European Radiocommunications Office). Lista e pajisjeve do të jetë e prezantuar nëpërmjet faqes zyrtare të AKEP-it në internet www.akep.al. Njoftimi dhe procedura e njohjes së konformitetit është e detyrueshme për të gjitha pajisjet radio, që prodhohen, importohen, vendosen në treg dhe përdoren, me përjashtim të atyre rasteve kur AKEP-i nuk duhet të njoftohet.

Ne mendojmë se konstatimi i Operatorit B nuk është i saktë. Në trajtimin e këtij problemi duhet që të vlerësohet jo vetëm Paragrafi 5.5, por edhe Paragrafi 5.6 i VKM 331. Lista e pajisjeve, për të cilat nuk duhet kryer procesi i njohjes së konformitetit, është hartuar duke u bazuar në strukturën e grupeve të pajisjeve të paraqitura në Paragrafin 5.5. Pra, të gjitha grupet e pajisjeve sipas paragrafit 5.5 të VKM 331, janë të përfshira në Listën e përgatitur nga AKEP, duke i detajuar ato mbështetur në materialet e rekomanduara nga European Commission/European Radiocommunications Office. Përveç këtyre grupeve, bazuar në Paragrafin 5.6 të VKM 331, në Listë janë të përfshira edhe pajisjet radio të Klasës 1 që punojnë në breza frekuencash të harmonizuara. Të gjitha këto vlerësime janë të njëjta me përmbajtjen e paragrafëve 5.4 dhe 5.5 të dokumentit të draft Rregullores së publikuar për këshillim publik.

Të gjitha këto mund të konstatohen edhe në Listën e publikuar në faqen zyrtare të AKEP.

3. Operatori B ka ngritur disa probleme lidhur me njohjen e konformitetit të antenave që kanë në përdorim.

Komenti i AKEP: Trajtimi i problemit të antenave është jashtë kuadrit të këshillimit publik për Rregulloren “Për Pajisjet Radio dhe Fundore të Telekomunikacioneve dhe Njohjen e Konformitetit të tyre”. Për këtë arsye, trajtimi i tij do të bëhet në mënyrë të vecantë.

Tiranë,14.06.2012